

**AKT THEMELEMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**NextGen Solutions “NGS” SHPK**

**NENI 1**

Në Tiranë, sot më datën **11/01/2023**, në bazë të Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 ‘Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare’ dhe Ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qëndrën Kombëtare te Regjistrimit”, themelohet shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar me emërtimin **NextGen Solutions “NGS” SHPK**.

**NENI 2**

Ortaku i vetëm i shoqërisë është:

- **Z. Kevin Baliaj**, lindur në Gjirokastrë më 02/03/1995 dhe banues në Tiranë , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar ,identifikuar me kartë identiteti me Nr. Personal J50302064P.

**NENI 3**

*Emërtimi*

Emërtimi i plotë i shoqërisë është Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar **NextGen Solutions “NGS” SHPK**.

**NENI 4**

*Selia*

Seli e Shoqërisë **NextGen Solutions “NGS” SHPK**.do të jetë :

Rr. Cameria, Tirane, Ndertesë 9, Hyrja 3, Njësia administrative nr. 10 Kodi postar 1001

Përveç ushtrimit të aktivitetit në nivel qendror, shoqëria ka të drejtë të hap degë dhe zyra perfaqësimi brenda vëndit ose jashtë vëndit. Selia e Shoqërisë mund të ndryshoj me vendim të Asamblesë së Përgjithëshme.

**NENI 5**

*Kohëzgjatja*

Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar, dhe do të fillojë nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përjashtim të rastit kur mbaron sipas parashikimeve të ligjit ose kur vendos Asambleja e Përgjithëshme.



**NENI 6**  
**Objekti i Veprimtarisë**

Objekti i Veprimtarisë është:

- Shoqëria do të jetë partneri, konsulenti dhe firma menaxhuese e preferuar për shitës të ndryshëm harduerësh dhe softuerësh në fushën e teknologjisë së informacionit dhe zgjidhjeve strategjike. Kompania do të shërbejë si ndërmjetëse ose menaxhere, por jo e kufizuar, për importin dhe shitjen e harduerit dhe softuerit, rishitje të autorizuar, shpërndarje sistemesh, shërbime të avancuara dhe të menaxhuara në fushën e teknologjisë së informacionit dhe zgjidhjeve strategjike në Evropën Lindore.

**NENI 7**  
**Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100 (njëqind) Leke, i zotëruar nga ky ortak:

Emri, Mbiemri	% që zotëron	Kuotat që zotëron	Shuma e kapitalit
<b>Kevin Baliaj</b>	100 %	1 kuotë	100 lek

**NENI 8**

Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. Bardhyl Baliaj** I biri i Agron lindur në Bajram Curri ,Tropoje më 08/02/1997 dhe banues ne Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar ,identifikuar me karte identiteti Nr. Personal J70208049B

**NENI 9**

Drejtimi, organizimi dhe funksionimi i shoqërisë rregullohet sipas dispozitave të legjisllacionit shqiptar si dhe në baze të Statutit dhe këtij Akti Themelimi.

**NENI 10**  
**Dispozita e fundit**

Ky akt themelimi është perpiluar në 5 (pesë) kopje, në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë ligjore.

**Ortaku i vetëm i Shoqërisë**  
**Kevin Baliaj**

Kevin Baliaj

